

V E N D I M
Nr.478, datë 7.11.1992

**PËR KRIJIMIN, EVIDENCIMIN DHE ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE QË
REALIZOJNË INSTITUCIONET BUXHETORE NGA SHËRBIMET QË ATO U OFROJNË
TË TRETËVE**

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Institucionet, të cilat financohen krejtësisht nga buxheti i shtetit, kanë të drejtë që, krahas veprimtarisë së tyre kryesore, të kryejnë edhe veprimtari e shërbime të tjera kundrejt pagesës, si organizim shfaqjesh e ekspozitash, shitje të objekteve të riprodhuara në pikturë, skulpturë etj., organizim konkurse reklamash, riprodhim kasetash e videokasetash, shërbime të ndryshme kancelerie etj., shitje lojtarësh, si dhe veprimtari e shërbime të tjera, që specifikohen në udhëzimet përkatëse të çdo institucioni për zbatimin e këtij vendimi.

2. Fitimi që krijojnë këto institucione buxhetore nga shërbimet ose veprimtaritë që ato u ofrojnë të tretëve, të derdhet në një llogari të veçantë dhe jo në llogarinë ku financohen shpenzimet e buxhetit të shtetit.

Në fund të çdo tremujori ministritë dhe institucionet e tjera qendrore rakordojnë me Drejtorinë e buxhetit të shtetit në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë për masën e realizimit të tij, 50 për qind e të cilit do të mbahet nga vetë instituconi, kurse 50 për qind do të derdhet në llogarinë e të ardhurave të buxhetit të shtetit.

3. Kryesia e Këshillit të Ministrave, kur e gjykon të arsyeshme, ka të drejtë ta rritë masën e të ardhurave që u lihet në dispozicion institucioneve që financohen tërësisht nga buxheti.

4. Të ardhurat mund të përdoren për investime, përmirësimin e kushteve të punës, përsosjen teknike ose për nevoja të tjera të institucioneve, si dhe për shpërblimin e punonjësve. Kriteri dhe masa e përdorimit të tyre do të përcaktohen më hollësisht në udhëzimet përkatëse të çdo institucioni për zbatimin e këtij vendimi.

5. Të ardhurat që do t'i mbeten institucionit dhe shpenzimet që do të përballohen nga këto të ardhura, të pasqyrohen si aneks në situacionin e shpenzimeve të buxhetit të shtetit.

6. Këtij vendimi t'i nënshtrohen të ardhurat e realizuara nga institucionet buxhetore që nga data 1 korrik e vitit 1992.

7. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë që, në bashkëpunim me ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, të nxjerrë udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi